

Departamenti për të Drejta të Njeriut dhe Komunitete

Sektori për Monitorimin e Sistemit Ligjor

Raport mujor – Maj 2009

Dështimi i prokurorëve në hetimin dhe ndjekjen e shpejtë dhe efektive të rasteve të pretenduara të mashtrimeve gjatë zgjedhjeve shkel detyrën e tyre të “kujdesit të duhur”

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) është e brengosur që mashtrimet gjatë zgjedhjeve që janë pretenduar të jenë kryer gjatë zgjedhjeve të 17 nëntorit 2007 mund të kalojnë pa ndjekjen e duhur. Kjo mund të shkojë deri në nivelin e shkeljes së detyrës së kujdesit të duhur nga ana e prokurorëve në bazë të ligjeve vendore e ndërkombëtare. Po ashtu, kjo mund të përbëjë shkelje të standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Në raportin e mëhershëm mbi këtë çështje,¹ OSBE-ja ka shënuar që pohimet e besueshme mbi mashtrimet e kryera gjatë zgjedhjeve të mbajtura më 17 nëntor 2007 nuk kanë çuar në hetimin apo ndjekjen e shpejtë dhe efektive penale të kryesve të pohuar. OSBE-ja pastaj lëshoi një numër rekomandimesh drejt shqyrtimit të mangësive të identifikuara në shqyrtimin e këtyre rasteve. Ky raport analizon zhvillimet më të fundit në shqyrtimin e rasteve të mashtrimeve në zgjedhje nga të gjitha zyrat komunale të prokurorisë publike, të cilat kanë pranuar kësi lloj rastesh.

Sfondi

Më 17 nëntor 2007 janë mbajtur zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës, kuvendet komunale dhe zgjedhjet për kryetarë komunash në Kosovë. Vëzhguesit ndërkombëtarë të zgjedhjeve konkluduan atëbotë që zgjedhjet ishin mbajtur përgjithësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe evropiane, përkundër një numri mangësive kryesisht në lidhje me administrimin e zgjedhjeve, përfshirjen e bashkësisë ndërkombëtare, mospjesëmarrjen e serbëve të Kosovës, si dhe me numrin alarmant të ulët të votuesve në zgjedhje.²

Derisa organizimi dhe mbajtja e zgjedhjeve ishte vlerësuar si përgjithësisht pozitive, ishin regjistruar disa parregullsi në votime në vendvotime të caktuara. Parregullsitë e pohuara përbëheshin kryesisht nga frikësimi i votuesve, keqpërdorimet dhe manipulimet në vota, shkatërrimi i fletëvotimeve, si dhe falsifikimi i rezultateve të votimit.

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (KZAP), organ ky i pavarur i themeluar për të shqyrtuar dhe gjykuar mbi ankesat në zgjedhje, kishte grumbulluar dhe analizuar gjitha raportet që pohonin për parregullsi në votim. Më 30 nëntor 2007, KZAP-i lëshoi një mendim që parregullsi votimi kishte pasur në 31 vendvotime të Kosovës, duke anuluar rezultatet zgjedhore në këto vendvotime.³ Përgjithësisht, KZAP-i kishte anuluar

¹ Shih Raportin Mujor të Sektorit për Monitorimin e Sistemit Ligjor, tetor-nëntor 2008.

² Shih *Raportin përfundimtar të Misionit të Këshillit të Evropës për Vëzhgimin e Zgjedhjeve në Kosovë (CEEOM V)*, të 28 marsit 2008.

³ Shih: Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia, rasti nr. KZAP 07/263C, Gjykim, 30 nëntor 2007.

votimet në 1.3 përqind të vendvotimeve, si dhe 34.000 vota me postë. Me një vendim të datës 13 dhjetor 2007, KZAP-i anuloi rezultatet nga nëntë vendvotime tjera shtesë.⁴ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) më vonë shfuqizoi rezultatet nga tre vendvotime tjera shtesë në bazë të një rekomandimi nga Qendra e Numërimit dhe Rezultateve.⁵ Përsëritja e zgjedhjeve nuk u organizua, pasi ri-votimi ishte përcaktuar që nuk kishte ndikim vendimtar në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve.

Më 20 mars 2008, pas përfundimit të hetimeve të tij mbi parregullsitë e raportuara zgjedhore, KZAP-i i dërgoi vrojtimit e veta tek Zyra e Prokurorit Publik të Kosovës për hetime të mëtutjeshme dhe ndjekje të mundshme të veprave penale në lidhje me zgjedhjet.⁶ KZAP-i dorëzoi më shumë se njëqind dosje⁷ me dokumente në lidhje me veprat e pohuara, duke përfshirë formularët origjinalë të raporteve hetuese, librat e votave, formularët e numërimit të rezultateve, si dhe listat përfundimtare të votuesve. Kutitë e votimit me fletëvotimet në fjalë nuk janë dorëzuar, por janë mbajtur në “karantinë” nën autoritetin e KQZ-së, në dispozicion për hetime në bazë të kërkesës.⁸

Më 2 prill 2008, Prokurori Publik i Kosovës, pa marrë asnjë veprim hetues⁹ i dorëzoi gjitha materialet e pranuar nga KZAP-i tek prokurorët komunalë kompetentë për territoret e caktuara, të cilët morën detyrën e hetimit të pohimeve për parregullsi zgjedhore, si dhe nëse ka nevojë, ndjekjen e të dyshuarve.

Duke pasur parasysh nevojën për të vënë para përgjegjësisë fajtorët për paligjshmërinë, si dhe duke marrë parasysh ndikimin të cilin hetimet penale do të mund të kishin mbi frenimin e veprave të tilla në zgjedhjet e ardhshme, OSBE-ja ka vëzhguar së afërmi hetimet që janë ndërmarrë nga prokurorët publikë komunalë në këto raste.

Rëndësia e zgjedhjeve të lira e të drejta si dhe domosdoshmëria e ndjekjes së mashtrimeve në zgjedhje

⁴ Shih: Vendimi i KZAP-it 07/419C. Shih edhe Rekomandimin e KQZ-së për të certifikuar Rezultatet e Zgjedhjeve për Kryetarë Komunash në Kosovë, Letra e KQZ-së për Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm, me datë 18 dhjetor 2007.

⁵ Shih Rekomandimin e KQZ-së për certifikimin e Rezultateve të Zgjedhjeve për Kuvende Komunale në Kosovë, Letra e KQZ-së për Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm, me datë 18 dhjetor 2007.

⁶ Këto krime përfshijnë edhe privimin e ushtrimit të së drejtës së votimit (Neni 176, Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut, nr. 2003/25, 6 korrik 2003, me ndryshimet vijuese (më tutje në tekst: Kodi Penal i Kosovës); shkeljen e vendimit të lirë të votuesit (neni 177); keqpërdorimi i të drejtës së votimit (neni 178); shkelja e fshehtësisë në votim (neni 179); mashtrimi në zgjedhje 180); si dhe shkatërrimi i dokumenteve të votimit (neni 181).

⁷ Disa nga këto dosje të KZAP-it, me numra të ndryshëm të dosjeve, i referoheshin parregullsi të kryera në një vendvotim të caktuar. Gjithashtu, në disa raste nuk ishte e qartë nëse kishte ngjarë një veprim i paligjshëm, apo siç tregohet nga rezultatet gabime teknike më shumë sesa mashtrim në zgjedhje. Vijimisht, prokurorët kanë hapur dhe shqyrtuar më pak raste sesa numri i dosjeve të dërguara nga KZAP-i..

⁸ Shih Letrën nga Gjyqtar Norbert Koster, Krye-Komisionar, Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa, për Hilmi Zhitija, Prokuror Publik i Kosovës.

⁹ Intervista e OSBE-së me Z. Hilmi Zhitija, Prokuror Publik i Kosovës, 25 shtator 2008.

Zgjedhjet e lira e të drejta janë normë fundamentale e një shoqërie demokratike, si dhe ekzistojnë shumë dokumente politike e ligjore që reflektojnë këtë parim të rëndësishëm.¹⁰ Vetë Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut (GjEDNj), në të drejtën lëndore të saj mbi të drejtën për zgjedhje të lira,¹¹ disa herë ka konfirmuar që zgjedhjet e lira përforcojnë “parimin karakteristik të një demokracie efektive dhe rrjedhimisht kanë rëndësi primare në sistemin e Konventës”¹² si dhe që janë “qenësore për themelimin dhe ruajtjen e themeleve të një demokracie efektive dhe kuptimplote, të qeverisur nga sundimi i ligjit”.¹³

Gjykata Evropiane gjithashtu ka theksuar se e drejta për zgjedhje të lira përbëhet nga dy aspekte: “aspekti aktiv, pra e drejta për të votuar, si dhe aspekti pasiv, pra e drejta për të konkurruar si kandidat për zgjedhje”.¹⁴

Të dy aspektet, aktive e pasive, të së drejtës për të votuar, duhen ruajtur dhe mbrojtur me kujdes për të pasur zgjedhje vërtetë të lira e të drejta. Një nga mënyrat për të arritur këtë është përmes hetimeve efektive të rasteve të parregullsive zgjedhore, si dhe përmes ndjekjeve rigoroze të personave të dyshuar për përfshirje në vepra të tilla.¹⁵

Si me gjitha krimet, prokurorët kanë për të detyrë të kenë vëmendjen dhe kujdesin e duhur në ndjekjen dhe hetimin e veprave penale në lidhje me zgjedhjet. Ky obligim i prokurorëve është i parashikuar me dokumentet ndërkombëtare dhe me ligjet vendore. Kështu, Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara mbi Rolin e Prokurorëve theksojnë që prokurorët duhet të kenë rol aktiv në procedurat penale, duke përfshirë iniciimin e hetimeve.¹⁶ Ngjashëm, edhe Kodi i Procedurës Penale i Kosovës parashikon që “prokurori publik do të iniciojë hetimin ndaj një personi të caktuar, në bazë të kallëzimit penal apo burimeve tjera, nëse ka dyshim të arsyeshëm që ai person ka kryer një veprë penale e cila hetohet sipas detyrës zyrtare (*ex officio*).”¹⁷ Hetimi normalisht duhet të përfundojë brenda një periudhe gjashtë-mujore, e cila mund të zgjatet vetëm në rastet e veprave komplekse dhe serioze.¹⁸

¹⁰ Shih: *Dokumenti i Kopenhagës 1990*, OSBE; *Komenti i Përgjithshëm 25*, Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Njeriut, në interpretimin e parimeve për zgjedhjet demokratike; shih edhe: *Kodi i Praktikave të Mira në Çështjet Zgjedhore*, hartuar nga Komisioni Evropian për Demokracinë përmes Ligjit (Komisioni i Venecias) të Këshillit të Evropës.

¹¹ E drejta për zgjedhje të lira është e parashikuar me nenin 3 të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave Njerëzore dhe Lirive Fundamentale (më tutje: Konventa Evropiane).

¹² Shih: *Tânase dhe Chirtoacă kundër Moldavisë*, Vendimi i GjEDNj, 18 nëntor 2008, paragrafi 100.

¹³ Shih: *Yumak dhe Sadak kundër Turqisë*, Vendimi i Dhomës së Lartë të GjEDNj, 8 korrik 2008, paragrafi 105.

¹⁴ Shih *Ždanoka kundër Letonisë*, Vendimi i Dhomës së Lartë të GjEDNj, 16 mars 2006, paragrafët 105 dhe 106.

¹⁵ *Kodi i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore*, hartuar nga Komisioni i Venecias - v. Fusnota 10 – parashikon në nenin 3.2 që autoritetet duhet të pamundësojnë dhe penalizojnë incidentet e frikësimit të votuesve, si dhe secilin lloj të mashtrimeve në zgjedhje.

¹⁶ Udhëzimet për Rolin e Prokurorëve, miratuar nga Kongresi i Tetë i Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Krimit dhe Trajtimin e Kundërvajtësve, 27 gusht deri më 7 shtator 1990.

¹⁷ Neni 220(1), Kodi i Përkohshëm i Procedurës Penale i Kosovës, shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/26, 6 korrik 2003, me ndryshimet vijuese (më tutje, Kodi i Procedurës Penale i Kosovës).

¹⁸ Neni 225, Kodi i Procedurës Penale i Kosovës.

Shqyrtimi i rasteve të mashtrimit në zgjedhje nga prokurorët publikë komunalë të Kosovës

Siç është thënë më lart, KZAP-i ka kryer hetimet e veta paraprake mbi incidentet e supozuara të parregullsive zgjedhore, si dhe pastaj i ka bartur gjykimet e veta tek Zyra e Prokurorit Publik të Kosovës, i cili pastaj ka shpërndarë rastet tek zyrat kompetente të prokurorëve publikë komunalë, në bazë të rregullit të juridiksionit territorial.

OSBE-ja është në dijeni se zyrat komunale të prokurorisë kanë shqyrtuar 36 raste, ku përfshihen së paku 57 persona, për të cilët pohohet të kenë manipuluar në mënyrë aktive procesin zgjedhor, apo së paku kanë heshtur për sjellje të pahijshme.

Deri më këtë datë, nuk është mbajtur asnjë proces gjyqësor në asnjë nga rastet e mashtrimeve në zgjedhje, pavarësisht faktit se ka kaluar një vit e gjysmë që nga koha kur incidentet e pohuara kanë ndodhur. Në përgjithësi, tetë raste janë hedhur poshtë, 16 raste ose kanë ngecur ose janë në pritje për t'u zgjidhur,¹⁹ dhe deri më tani 12 aktakuza janë konfirmuar dhe janë në pritje të gjyqimit. Fazat në të cilën janë procedurat penale dallojnë shumë nga rajoni në rajon.²⁰

Zyra e Prokurorit Publik të Komunës së Gjakovës ka zhvilluar hetime në dhjetë raste të mashtrimit në zgjedhje. Në fillim të qershorit 2008, prokurorët morën në pyetje dhjetë të pandehur dhe i dërguan dosjet e rasteve në polici për hetime të mëtejshme, por pa udhëzime specifike. Pas shqyrtimit të raporteve të policisë, deklaratave të të pandehurve dhe “dokumenteve tjera nga dosjet e rasteve”, në janar 2009 prokurorët i pushuan hetimet në të gjitha dhjetë rastet duke cituar mungesën e dyshimit të arsyeshëm se të dyshuarit kanë kryer mashtrim në zgjedhje.²¹ Në disa raste, prokurorët gjithashtu iu referuan faktit se ueb-faqja zyrtare e KQZ-së nuk përmbante kurrfarë vendimi zyrtar që konteston rezultatet e zgjedhjeve në Komunën e Gjakovës.

Zyra e Prokurorit Publik të Komunës së Gjilanit ka zhvilluar hetime në dhjetë raste të mashtrimit në zgjedhje, për të cilat dyshohej të jenë kryer në Viti. Prokurorët komunalë ngritën aktakuza kundër 20 personave të dyshuar. Shumica e aktakuzave bazoheshin vetëm në gjetjet e KZAP-it pa fakte tjera të gjetura përmes hetimeve shtesë, me përjashtim të një rasti ku prokurori i morri në pyetje të pandehurit para se të paraqiste aktakuzën. Ndonëse në masë të madhe të pambështetura në fakte dhe dëshmi, aktakuzat kundër 19 të

¹⁹ Deri sa neni 225 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës parasheh një kohëzgjatje normale prej 6 muajsh për hetime penale (me mundësi vazhdimi në raste të ndërlikuara), disa hetime janë ende “në pritje për t'u zgjidhur” edhe pas një viti e gjysmë, sepse prokurorët ose nuk kanë zhvilluar hetime, ose kanë ndërmarrë disa masa hetimore (siç janë marrjet në pyetje) pa e paraqitur vendimin për fillimin e hetimeve, siç kërkohet me nenin 221. Një shmangie e tillë nga obligimi për t'i përfunduar hetimet brenda afatit kohor të parashkruar me ligj – një praktikë mjaft e shpeshtë, që nuk është e kufizuar vetëm te rastet e mashtrimit gjatë zgjedhjeve – është një brengë tjetër.

²⁰ Vëreni që nuk janë raportuar kurrfarë parregullsish gjatë zgjedhjeve në rajonin e Mitrovicës.

²¹ Neni 224(1), Kodi i Procedurës Penale i Kosovës. Kjo bazë është cituar në të gjitha gjashtë rastet.

pandehurve u konfirmuan në qershor dhe korrik 2008. Për arsye të mungesës së madhe të punonjësve gjyqësor dhe mbingarkesës së madhe me raste në Gjykatën Komunale në Viti, ende nuk është caktuar koha e gjykimeve në këto raste – kjo, pavarësisht nga fakti se ligji kërkon që gjykimi të fillojë më së voni brenda një muaji pas konfirmimit të aktakuzës.²²

Zyra e Prokurorit Publik të Komunës së Prishtinës ka zhvilluar hetime në tetë raste të mashtrimit në zgjedhje. Në shtatë prej tetë rasteve, prokurorët i dërguan dosjet e rasteve të KZAP-it te policia për hetime të mëtutjeshme pa udhëzime specifike. Në një nga tetë rastet prokurori gjithashtu urdhëroi që të merret mendimi i ekspertit me qëllim të përcaktimit të vërtetësisë së nënshkrimit. Vetëm në tre raste prokurorët i kanë marrë në pyetje të dyshuarit dhe dëshmitarët. Dy raste janë hedhur poshtë, dy aktakuza janë konfirmuar nga fundi i janarit 2009, dhe katër raste janë në pritje të hetimeve. Rastet për të cilat janë konfirmuar aktakuzat ende nuk kanë datë të caktuar për fillimin e gjykimit.

Zyra e Prokurorit Publik të Komunës së Prizrenit ka pranuar 12 raste të mashtrimit të pohuar në zgjedhje. Prokurorët komunalë nuk e kanë marrë në pyetje asnjërin nga kryesit e pohuar e as që kanë zhvilluar ndonjë hetim më të plotë. Sipas prokurorëve, policia nuk mund të gjente vendndodhjen e disa të dyshuarve, ndërsa disa nga raportet e KZAP-it përmbanin informata të pamjaftueshme për të nisur hetime penale. Disa prokurorë thanë se u përpoqën t'i gjenin adresat dhe informata tjera për disa nga të dyshuarit nga Departamenti i Administratës Civile, por kjo nuk dha rezultat.

OSBE-ja mund të konfirmojë se prokurorët publik komunalë janë ballafaquar me disa sfida gjatë trajtimit të këtyre rasteve. Disa nga raportet që i pranuan prokurorët nga KZAP përmbanin informacione të kufizuara, duke i përshkruar shkurtimisht parregullsitë e regjistruara në një vendvotim të veçantë. Vetëm disa nga dosjet përmbanin ankesa zyrtare të parashtruara nga dëshmitarët okularë, dhe kishte gjithashtu raporte që nuk përmbanin informacione që tregonin për dëshmitarë specifikë apo kryerës të drejtpërdrejtë të veprës. Një sfidë tjetër me të cilën u ballafaquan prokurorët në hetime ishte padisponueshmëria e anëtarëve të KZAP-it për më shumë informacione dhe sqarime në raportet e KZAP-it.²³ Gjithashtu, vet tema e mashtrimit në zgjedhje është një temë me të cilën prokurorët komunal nuk kishin përvojë paraprake.

Megjithatë, këto sfida të hetimit nuk janë të pakalueshme. Raportet e KZAP-it janë vetëm pika e fillimit në hetime, dhe prokurorët kanë përgjegjësinë e fundit mbi hetimet penale.

²² Neni 319(2), Kodi i Procedurës Penale i Kosovës.

²³ KZAP-i e 2007 u shpërbë në maj 2008, ndërsa KZAP-i e re u themelua në gusht 2008, në pajtim me ligjin e ri mbi zgjedhjet e përgjithshme (*Gazeta Zyrtare* nr. 31 e 15 qershorit 2008). Kështu, për një periudhë të konsiderueshme kohore, pavarësisht nga përpjekjet e përsëritura, prokurorët publik nuk mund t'i kontaktonin anëtarët e KZAP-it për të marrë më shumë informacione për rastet e mashtrimit në zgjedhje. Në të njëjtën kohë, disa anëtarë të ish KZAP-it iu bashkuan KZAP-it së re dhe si të tillë ata mund të kishin shërbyer si burim informacionesh.

Si të tillë, ata duhet të hetojnë në mënyrë energjike dhe nëse dëshmitë e lejojnë t'i ndjekin penalisht individët e dyshuar për sjellje të pahijshme në zgjedhje. Aty ku ekziston një pohim i besueshëm, pjesë informimi, ose ndonjë dëshmi relevante për identifikimin e të dyshuarve, autoritetet janë të obliguara sipas ligjit që të zhvillojnë në mënyrë efektive hetime të mëtejshme me synim të ndjekjes së mundshme të suksesshme të kryesve. Normalisht, hetimet do të duhej të ishin në gjendje të përcaktonin shkakun e shkeljeve dhe të çojnë deri te identifikimi i të gjithë atyre që janë përgjegjës, me synim që të japin llogari.

Është e qartë se ky obligim për zhvillimin e hetimeve efektive nuk mund të jetë obligim absolut edhe për faktin se shumë krime mbesin të pazgjidhura përkundër përpjekjeve të arsyeshme të ndërmarra nga autoritetet e rendit dhe ligjit. Si i tillë, obligimi për të zhvilluar hetime efektive nuk është një nga rezultatet por një nga mjetet, dhe prokurorët dhe policia duhet të sigurojnë se i kanë ndërmarrë të gjitha veprimet e mundshme që t'i hetojnë mashtrimet në zgjedhje në mënyrë kompetente dhe efikase, ashtu siç do të duhej të vepronin me çfarëdo krimi tjetër.

OSBE-ja kupton sfidat praktike me të cilat u ballafaquan prokurorët në disa nga këto raste dhe gjithashtu është e vetëdijshme për nevojën e prokurorëve për të bërë zgjidhje operacionale dhe për t'i dhënë prioritet hetimeve të rasteve tjera, të krimeve më të rënda. Megjithatë, duket se disa prokurorë publik komunal nuk kanë bërë sa duhet për ta përbushur obligimin e tyre për zhvillimin e një hetimi efektiv në mashtrimin e dyshuar në zgjedhje.

Shumë raporte të KZAP-it përmbanin emra specifikë të individëve për të cilët pohohej të kenë qenë të përfshirë në mashtrim në zgjedhje, ose së paku të kenë qenë të pranishëm në kohën kur dhe vendin ku ka ngjarë mashtrimi. Megjithatë, në disa rajone nuk kishte tregues se janë marrë deklarata nga dëshmitarë relevantë, përshirë këtu edhe dëshmitarët okular dhe në disa raste prokurorët madje dështuan t'i merrnin në pyetje të dyshuarit, emrat e të cilëve ishin të përmendur në mënyrë të qartë në raportet e KZAP-it.

OSBE-ja vërejtë se në disa raste prokurorët nuk kishin paraqitur vendim për fillimin e hetimeve. Ata thjeshtë i kishin dërguar dosjet në polici (ndonjëherë njësisë së gabuar, siç është Njësia e Policisë për Krime Ekonomike), por më së shpeshti pa udhëzime specifike, e që me kohë rezultoi në përfundimin e procedurave për mungesë të dëshmitëve. Disa prokurorë dolën me arsyetime mjaftë të paqëndrueshme për mos vazhdimin e hetimeve të tyre. Arsyetime të tilla përfshinin pamundësinë e gjetjes, për qëllime të marrjes në pyetje, të dëshmitarëve, të cilët në fakt ishin punonjës në poste publike komunale dhe të cilët lajmërohen në punë çdo ditë. Në anën tjetër, pas zhvillimit të pak apo aspak hetimeve, disa prokurorë i akuzuan të dyshuarit përmes aktakuzave që mbështeteshin në shumë pak dëshmi. Rezultati përfundimtar i ndjekjeve të tilla është mjaftë i paqartë.

Të gjitha këto tregojnë për një dështim të dukshëm për hetim efektiv dhe ndjekje të rasteve të mashtrimit në zgjedhje në disa komuna. Kjo mund të përbëjë shkelje të obligimeve profesionale të prokurorëve dhe detyrave që kërkojnë kujdes të veçantë. Kjo, gjithashtu, mund të përbëjë shkelje të standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut,

bazuar në të cilat, mangësitë e rënda dhe flagrante në hetimet dhe ndjekjet penale, madje edhe të rasteve të krimeve më pak të rënda, përbëjnë dështim të autoriteteve për të përmbushur obligimet e tyre pozitive për t'i mbrojtur të drejtat e njeriut.²⁴

Hetimi efektiv i veprave penale të lidhura me zgjedhjet siguron jo vetëm llogaridhënien e fajtorëve për krime të tilla, por gjithashtu shërben për t'i shmangur sjelljet e tilla të pahijshme në të ardhmen. Në anën tjetër, dështimi për t'i hetuar dhe ndjekur në mënyrë energjike rastet e mashtrimit në zgjedhje mund të nxisë mosndëshkimin dhe përfundimisht të çojë në përsëritje të sjelljeve të pahijshme në zgjedhjet pasuese. Kjo mund të rezultojë përsëri në shpalljen e fletëvotimeve si të pavlefshme, rezultate të vonuara të zgjedhjeve, ose madje me nevojën për përsëritje të zgjedhjeve, nëse mashtrimet janë kryer në një shkallë më të gjerë. Duhet pasur parasysh që çfarëdo minimi i procesit të zgjedhjeve është në fakt shkelje e besimit të publikut, gjë që mund ta dobësojë këtë besimin në procesin e zgjedhjeve dhe ta pengojë zhvillimin e demokracisë dhe sundimit të ligjit në Kosovë.

Konkludim

Duke e pasur parasysh atë që u tha më sipër, OSBE-ja i rikonfirmon rekomandimet e bëra në raportin e saj në nëntor 2008:²⁵

- Prokurorët do të duhej t'i hetonin me kohë dhe në mënyrë efikase rastet e pohuara të mashtrimit në zgjedhje duke i shfrytëzuar të gjitha mjetet në dispozicion. Nëse ka mjaft dëshmi mbështetëse, rastet duhet të ndiqen në mënyrë energjike.
- Gjatë referimit të një rasti në polici për hetime të mëtutjeshme, prokurorët do të duhej t'i siguronin policisë udhëzime specifike për masat hetimore që duhet të ndërmerren. Më pas, prokurorët duhet të mbikëqyrin policinë dhe të sigurojnë që ajo po i zbaton urdhrat e dhëna në mënyrë efikase dhe me kohë.
- Instituti Gjyqësor i Kosovës, në bashkëpunim me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, duhet të sigurojë trajnim për gjykatësit dhe prokurorët mbi ligjin e zgjedhjeve dhe mënyrat e trajtimit të rasteve të mashtrimit në zgjedhje.
- Organet relevante të zgjedhjeve siç janë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Komisioni i Zgjedhjeve për Parashtesa dhe Ankesa, Komisionet komunale të zgjedhjeve, si dhe këshillat e vendvotimeve duhet të bashkëpunojnë me prokurorët të cilët i hetojnë mashtrimet në zgjedhje.

Më tej, OSBE-ja gjithashtu rekomandon që:

- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve do të duhej që në mënyrë periodike të kërkojë informata nga prokurorët mbi progresin e arritur në hetimin dhe ndjekjen e rasteve të mashtrimit në zgjedhje.

²⁴ shih *Blumberga kundër Letonisë*, aktgjykimi i GjEDNj-së i 14 tetorit 2008, paragrafi 67.

²⁵ Shih raportin mujor të SMSL-së për tetor-nëntor 2008.

- Prokurorët e EULEX-it duhet ndoshta të mendojnë për marrjen përsipër të rasteve të mashtrimit në zgjedhje kur prokurorët publikë të Kosovës duket të jenë të pavullnetshëm apo të mos jenë në gjendje për t'i kryer detyrat e tyre dhe kur kjo mungese e vullnetit apo kjo pamundësi mund t'i rrezikojë hetimet ose ndjekjen e veprave penale në fjalë.²⁶

²⁶ shih nenin 12 të Ligjit të zbatueshëm nr. 03/L-053 mbi juridiksionin, përzgjedhjen e rasteve dhe ndarjen e rasteve të gjykatësve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë, 3 qershor 2008.